REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 314, Datë 26.10.2026

MBI

KËRKESËN E SHOQËRISË "EN.KU" SH.P.K. PËR AUTORIZIMIN E BARRËSIMIT TË KUOTAVE DHE ASETEVE TË SAJ, SI DHE DHËNIEN E AUTORIZIMIT PËR VENDOSJEN E BARRËS SIGURUESE MBI KUOTAT, SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMEVE NDAJ "BANKA OTP ALBANIA" SH.A.

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 59/2026 *"Për sektorin e energjisë elektrike"*; neneve 9, pika 8, dhe 10 të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve*, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE*-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.10.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 3043/4 prot., datë 23.10.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës *"Mbi kërkesën e shoqërisë "En.Ku" sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave dhe aseteve, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj "Banka OTP Albania" sh.a.*",

Konstatoi se:
Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për shoqërinë "En.Ku" sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për Marrjen e Autorizimit

- Shoqëria "En.Ku" sh.p.k. është licencuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 86, datë 17.07.2008, të ndryshuar, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Bicaj", me kapacitet 3.1 MW, me vendndodhje në Kukës.
- Me shkresën nr. 3043 prot., datë 12.10.2026, shoqëria ka paraqitur aplikimin dhe dokumentacionin për marrjen e autorizimit nga ERE për barrësimin e kuotave dhe aseteve të saj, në favor të palës kredidhënëse "Banka OTP Albania" sh.a.
- Nga dokumentacioni i administruar rezulton se kërkesa është paraqitur në kuadër të kontratës së kredisë bankare të lidhur ndërmjet "Banka OTP Albania" sh.a., në cilësinë e kredidhënësit, dhe shoqërisë "BESNIKU" sh.p.k., në cilësinë e kredimarrësit dhe ortakut të vetëm të shoqërisë "En.Ku" sh.p.k.

2. Shqyrtimi i Kërkesës dhe Kërkesa për Dokumentacion Plotësues

- Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar, është konstatuar se në kontratën e kredisë parashikohet vendosja e barrës siguruese mbi 100% të kuotave të shoqërisë "En.Ku" sh.p.k. dhe jo asetet fikse të saj. ERE nëpërmjet shkresës nr. 3043/2 prot., datë 21.10.2026 dhe emailit të së njëjtës datë, i kërkoi shoqërisë të kryente saktësimet përkatëse dhe, në rast se kërkesa përfshinte edhe vendosjen peng të aseteve fikse, të depozitonte dokumentacionin dhe informacionin e kërkuar sipas nenit 7 të Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.07.2016. Gjithashtu, në këtë shkresë shoqërisë i janë evidentuar mangësitë në dokumentacionin e paraqitur për barrësimin e kuotave dhe i është kërkuar plotësimi i tyre.
- Shoqëria me shkresën nr. 3043/3 prot., datë 22.10.2026 ka depozituar sa kërkuar në lidhje me procedurën e barrësimit të kuotave, si dhe ka përcjellë marrëveshjen e barrës siguruese të datës 09.10.2026, në lidhje me lënien peng të aseteve të luajtshme (llogaritë rrjedhëse/bankare të shoqërisë En.Ku sh.p.k.).
- **Në referencë të përcaktimeve të nenit 46, pika 2 të ligjit nr. ligjit nr. 59/2026 "*Për sektorin e energjisë elektrike*", dhe neneve 2, gë**rma "a", 3, 5, g**ë**rma "j" dhe 6 të *Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit*, miratuar me **v**endimin e **b**ordit të ERE-s nr. 119, datë 21.07.2016, miratimi paraprak nga ERE lidhet me transferimin e aseteve që i shërbejnë ushtrimit të veprimtarisë së licencuar, sipas kushteve të përcaktuara në këto dispozita. Në rastin konkret, nga dokumentacioni i administruar rezulton se marrëveshja e barrës siguruese përfshin llogaritë bankare të shoqërisë "En.Ku" sh.p.k., të cilat përfaqësojnë të drejta pasurore me natyrë financiare dhe jo asete fikse të impiantit të prodhimit të energjisë elektrike. Për rrjedhojë, vendosja e barrës siguruese mbi këto llogari nuk përbën transferim të aseteve fikse që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar dhe nuk i nënshtrohet procedurës së miratimit paraprak nga ERE sipas rregullores së sipërcituar. Ndërsa kërkesa për vendosjen e barrës siguruese mbi kuotat e shoqërisë shqyrtohet në përputhje me rregulloren e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021.

3. Përfundime dhe Kërkesa të tjera për Dhënien e Autorizimit

- Nga analiza e dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria "En.Ku" sh.p.k., rezulton se është dorëzuar dokumentacioni në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenet 5, 6, 7 dhe 8, të "*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve"*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021, si vijon:
- **Neni 5, pika 2** - Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese janë nënshkruar nga administratori z. Neritan Domi., si personi i autorizuar për të përfaqësuar shoqërinë, në përputhje me kërkesat e Rregullores.

4. Plotësimi i kërkesave të nenit 5:

- **Neni 5, pika 4** - Dokumentacioni është paraqitur në gjuhën shqipe, në format origjinal ose fotokopjoje të noterizuar dhe i shoqëruar me kopje elektronike.
- **Neni 5, pika 5** - Shoqëria nuk ka kërkuar që dokumentacioni i dorëzuar të konsiderohet

konfidencial.

5. Plotësimi i Kërkesës sipas nenit 8:

- **Pika 1** - Janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara mbi shoqërinë, përfaqësuesin e autorizuar, arsyet për vendosjen e barrës siguruese, përshkrimi i detyrimeve dhe deklarata mbi statusin e kuotave.
- **Pika 2** - Janë dorëzuar të gjitha dokumentet përkatëse, përfshirë ekstraktin historik të regjistrit tregtar, vendimet e organeve drejtuese, marrëveshjen përkatëse dhe dokumentacionin tjetër shtetëror si më poshtë vijon:
  - **Gërma "a"** - Ekstrakti historik i regjistrit tregtar.
  - **Gërma "b"** - Vendimi i organeve drejtuese: Është depozituar Vendimi i Ortakut të Vetëm të shoqërisë "En.Ku" sh.p.k. me nr. 02, datë 07.10.2026, me anë të së cilës është shprehur dakordësia mbi vendosjen e kuotave të kësaj shoqërie si garanci për shlyerjen e detyrimit ndaj "Bankës OTP Albania" sh.a..
  - **Gërma "c"** - Marrëveshjet përkatëse:
    - *"Kontratë Kredie Bankare" nr. 5645 rep, nr. 1301 kol, datë 09.10.2026*, të nënshkruar midis palëve, me qëllim financimin e nevojave për kapital qarkullues të shoqërisë BESNIKU sh.p.k.
- **Pika 3** - Shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj ERE-s, përsa i përket pagesave të rregullimit.

6. Kushtet e Vendosura për Dhënien e Autorizimit

- Dhënia e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë "En.Ku" sh.p.k., si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve, nuk e përjashton këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimet ose miratimet e nevojshme nga organet e tjera kompetente apo nga palët e treta përkatëse, në rast se kjo kërkohet nga kuadri ligjor ose nga marrëveshjet kontraktuale në fuqi.

- *Vendosja e këtij kushti bëhet për të garantuar se autorizimi i dhënë nga ERE mbetet i kufizuar vetëm në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj rregullatore, pa ndërhyrë apo anashkaluar detyrimet ligjore ose kontraktuale që mund të ketë shoqëria ndaj autoriteteve të tjera ose palëve të përfshira në marrëdhënie financiare apo tregtare. Në këtë rast, duke qenë se marrëveshja është nënshkruar me bankë vendase, është përgjegjësi e shoqërisë të respektojë çdo detyrim tjetër jashtë kompetencës së ERE-s që mund të rrjedhë nga këto marrëveshje.*
- Në referencë të nenit 9, pika 8 të Rregullores, ku citohet se shoqëria duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar, ku të reflektohet vendosja e kolateralit mbi kuotat e saj, *shoqëria duhet ta reflektojë këtë ndryshim në ekstraktin e saj, e ta përcjellë të përditësuar këtë të fundit pas pasqyrimit të ndryshimit në ERE.*
- Shoqëria detyrohet të njoftojë ERE-n në rast të heqjes së barrës siguruese ose të ekzekutimit të saj të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të mos marrë në shqyrtim kërkesën e shoqërisë "En.Ku" sh.p.k. për dhënien e autorizimi për vendosjen e aseteve të luajtshme të saj, si mjet për garantimin e detyrimeve ndaj "Banka OTP Albania" sh.a..
2. Të autorizojë vendosjen e barrës siguruese mbi 100% të kuotave të shoqërisë "En.Ku" sh.p.k., të zotëruara nga ortaku i vetëm i saj, shoqëria "BESNIKU" sh.p.k., si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj palës kredidhënëse "Banka OTP Albania" sh.a., sipas kontratës së kredisë bankare nr. 5645 rep., nr. 1301 kol., datë 09.10.2026.
3. Dhënia e Autorizimit nga ERE sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij vendimi nuk e çliron shoqërinë "En.Ku" sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.
4. Shoqëria "En.Ku" sh.p.k. të njoftojë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.
5. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në zbatim të pikës 4, apo në rast të depozitimit të dokumentacionit të ndryshëm nga ai që i ka shërbyer kësaj vendimmarrje.
6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë "En.Ku" sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI